



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Raport 9-mujor

Financat Publike Vendore

Janar – Shtator 2020

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Konstatime mbi treguesit financiarë të pushtetit vendor për 9 mujorin 2020 dhe efekti i pandemisë COVID-19

I. Te Ardhurat Vendore

- **Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në 9 mujorin 2020** janë realizuar **rreth 16.7 miliard lekë ose 73%** krahasuar me planin vjetor ose (rishikuar me aktin normativ të Qershorit rreth 23 miliard). Krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019, të ardhurat e veta vendore janë realizuar rreth **12%** më pak ose në vlerë absolute **2.2 miliard lekë**.
- **Efekti i COVID-19** është ndjerë në treguesit e të ardhurave të veta vendore gjatë 9 mujorit 2020 ku rënien më të madhe e ka pësuar zëri i **taksave lokale prej -14%**, dhe pas tij zëri i **taksave mbi pasurinë me rreth -7%** - krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Gjatë 9 mujorit të vitit 2020, në totalin e të ardhurave të veta të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore burimet më të rëndësishme me rreth **18% ose 2.9 miliard lekë e zë “Taksa mbi ndërtesën”, rreth 36% ose 6 miliard e zë “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja” dhe 17% ose 2.8 miliard lekë e zë “Tarifa e pastrimit dhe higjenës”**.
- Nga **taksat mbi pasurinë** në 9 mujorin 2020 janë akumuluar gjithsej **3.9 miliard lekë** ose rreth 200 milion lekë më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë. **Taksa mbi ndërtesën** zë peshën më të madhe me rreth **2.9 miliard lekë ose 76%** të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë.
- Në raport me totalin e të ardhurave nga taksat e pasurisë, gjatë 9 mujorit të vitit 2020, zëri i taksës mbi tokën bujqësore realizuar në vlerën e rreth **373 milion lekë** dhe zëri i taksës së transaksionit të pasurive të paluajtshme të realizuar në masën **403 milion lekë**, zënë vetëm **20%..**
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**, gjatë 9 mujorit të vitit 2020, me **6 miliard lekë zë 49%** në vlerën totale të “taksave të tjera lokale” (prej 12.4 miliard lekë). Nga ky burim i të ardhurave vendore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjatë 9 mujorit 2020 janë akumuluar rreth 1.1 miliard lekë më pak të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- **Bashkia Tiranës ka mbledhur rreth 59.7% të totali të të ardhurave vendore** (ose 10.9 miliard lekë) gjatë 9 mujorit të parë 2020. Ndërkohë që për bashkinë Tiranë burimi me të ardhurat më të mëdha është “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” e cila arrin vlerën e **4.8 miliard lekë**. “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” përbën **45%** të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë Tiranë, ose rreth **26%** të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.
- Të grupuara sipas numrit të popullsisë, bashkitë me mbi 100 mijë banorë (11 bashki përfshi edhe Tiranën) kanë realizuar **83%** të totalit të të ardhurave të veta vendore.
- Duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë** me mbi 100 mijë banorë kanë mbledhur rreth **4.1 miliard lekë ose rreth 56.6%** të totalit të të ardhurave vendore (për 60 bashkitë e mbetura).
- **13 bashkitë** me popullsi ndërmjet 50 -100 mijë banorë kanë mbledhur rreth **1.3 miliard lekë ose 18.5%** të totalit të të ardhurave vendore (te 60 bashki pa përfshirë Tiranën).
- **37 bashkitë** me popullsi nën 50 mijë banorë kanë mbledhur **1.8 miliard lekë ose 24.8%** të totalit të të ardhurave të veta vendore (te 60 bashki pa përfshirë Tiranën).

II. Shpenzimet Vendore


- **Totali i shpenzimeve të pushteti vendor** gjatë 9 mujorit të parë 2020 ishte rreth **41.2 miliard lekë shpenzime** ose rreth **77%** të planit vjetor të miratuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar rreth **2% më pak** ose në vlerë absolute rreth **1 miliard lekë**.
- Në shpenzimet e realizuara në 9 mujorin e vitit 2020, peshën më të madhe e zënë **shpenzimet e personelit me rreth 40.4%** e totalit të shpenzimeve vendore, pas tyre një peshë të madhe **zënë shpenzimet operative me rreth 24.3%**; ndërsa shpenzimet për investime janë ato që zënë peshën më të vogël.
- **Shpenzimet për investime pesuan një rënie të ndjeshme, në 9.4%** e totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor në 9 mujorin e vitit 2020, krahuar me **33%** që ishte kjo peshë një vit më parë. Si pasojë e efektit të pandemisë COVID-19, shpenzimet për investime **ranë në nivelin e 8 miliard lekë nga 14 miliard lekë** të realizuara në të njëjtën periudhë në 2019. **Ndërkohë që Bashkia e Tiranës zë 51%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- **Shpenzimeve të tjera korrente** (ku përfshihen edhe transfertat familjare, subvencionet) kanë pasur një rritje të ndjeshme gjatë 9 mujorit të parë 2020 duke arritur vlerën e **6.5 miliard lekë** ose **15.9%** e totalit të shpenzimeve Vendore. Keto shpenzime patën një rritje rreth **5.5 miliard lekë** më shumë se 2019, si rrjedhojë e mbështetjes së drejtpërdrejtë që dhanë njësitë e vetëqeverisjes vendore në ndihma për familjet e prekura nga efekti i pandemisë.
- Si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe pasigurisë së krijuar, pushteti vendor **ka ndryshuar strukturën e shpenzimeve sipas burimeve** duke rritur peshën e shpenzimeve nga transfertat e buxhetit qendror (57%) dhe ulur shpenzimet nga të ardhurat e veta vendore (41%), ndryshe nga e njëjta periudhë e një viti më parë kur kjo strukturë ishte e barabartë 50%-50%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjatë 9 mujorit të vitit 2020 njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë rritur **peshën e shpenzimeve nga transfertat e buxhetit qendror** me rreth **3 miliard lekë** më shumë dhe ulur ndjeshëm shpenzimet nga të ardhurat e veta me rreth **3.7 miliard lekë**.
- Për Bashkinë Tiranë **25%** e shpenzimeve janë financuar nga transfertat e buxhetit qendror dhe **75%** nga të ardhurat e veta.
- Në 9 mujorin e vitit 2020 konstatohet rritje të shpenzimeve në funksionet si “Rendi dhe Siguria”, “Çështjet Ekonomike” dhe “Mbrojtja e mjedisit” në vlerën totale prej **rreth 3.6 miliard lekë** më shumë se një vit më parë ose **28%** më shumë krahasuar me shpenzimet e këtyre funksioneve një vit më parë.
- **Funksioni i “mbrojtjes së mjedisit” ka rritjen më të madhe të shpenzimeve** gjatë 9 mujorit të vitit 2020 krahasuar me një vit më parë me rreth **1.4 miliard lekë ose 105% më shumë**, ku përfshihet trajtimi i mbetjeve dhe dizinfektimi si pasojë e masave të marra nga NJVQV-të për përballimin e situatës së COVID-19.
- **“Shërbimet e Përgjithshme publike”** kanë pësuar një rënie të shpenzimeve krahasuar me një vit më parë në funksionet rreth **800 milion lekë**, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” me rreth **2.1 miliard lekë** dhe “Arsimi” me rreth **700 milion lekë rreth 14%** më pak shpenzimeve për këto funksione krahasuar me një vit më parë.

- Bashkia Tiranë, në 9 mujorin 2020 ka realizuar rreth **31.1% të totalit** të shpenzimeve të pushtetit vendor **me një vlerë 12.7 miliard lekë**, ndërkohë që shpenzimet për investime të kësaj bashkie **zënë 51%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- Të grupuara sipas popullsisë në 9 mujorin 2020, duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë** me mbi 100 mijë banorë kanë realizuar rreth **26.4 miliard lekë ose 48%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki).
- 13 bashkitë me një popullsi ndërmjet 50 -100 mijë banorë kanë realizuar rreth **6.3 miliard lekë shpenzime ose 22%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki, pa Tiranën) dhe pjesa tjetër prej 37 bashkive që kanë popullsi nën 50 mijë banorë kanë realizuar **rreth 8.2 miliard lekë shpenzime ose ndryshe 29%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.


ANEKS
Paraqitja grafike
e treguesve financiarë

1. Treguesit e përgjithshëm fiskal

Garfiku 1: Të ardhurat dhe shpenzimet mujore të pushtetit vendor në 9M - 2020




Grafiku 2: Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve vendore në raport me planin vjetor




2. Treguesit e të ardhurave vendore


Grafiku 3: Raporti i të ardhurave në taksa dhe tarifa vendore gjatë 9M- 2020/2019




Grafiku 4: Përbërja e të ardhurave vendore sipas burimit, 9M - 2020




Grafiku 5: Taksa mbi pasurinë sipas burimit në 9M - 2020/2019



Grafiku 6: Përbërja në përqindje e taksave të pasurisë në 9M- 2020/2019




■ Taksa mbi ndërtesat
■ Taksa mbi tokën bujqësore




■ Taksa mbi truallin
■ Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme


Grafiku 7: Përbërja sipas burimit të taksave të tjera lokale




Grafiku 8: Përqindja e të ardhurave të veta sipas NJVQV-ve mbi totalin e të ardhurave vendore.




Grafiku 9: Përqindja e të ardhurave të veta sipas NJVQV-ve, mbi totalin e të ardhurave të veta vendore (pa përfshirë Bashkinë Tiranë)




Grafiku 10: Përbërja e të ardhurave vendore në përqindje në 9 mujorin 2020




Grafiku 11: Diferenca në totalin e të ardhurave vendore 9 mujori 2020/2019




Grafiku 12: Ndarja e të ardhurave të veta vendore sipas taksave e tarifave dhe të ardhurave jo-tatimore në 9 mujorin 2020



Grafik 13: Përbërja e të ardhurave nga taksa e pasurisë sipas NJVQV-ve në 9 mujorin 2020




Grafiku 14: Të ardhurat e veta të bashkive me mbi 100 mijë banorë (përfshirë Tiranën)




Nga analiza e të ardhurave të bashkive me popullsi ndërmjet 100-400 mijë banorë, konstatohet që mesatarisht bashkitë kanë patur një rritje të të ardhurave nga viti 2018 në vitin 2019 në rreth 10% dhe ulje të këtij raporti nga viti 2019 në vitin 2020 me rreth 24%. Gjithashtu, kjo kategori e bashkive rritjen më të madhe të të ardhurave e ka patur në vitin 2019, por pa përfshirë bashkitë si Kamza, Shkodra apo Berati që të ardhurat e veta vendore kanë ardhur me rënie nga viti 2018.

Grafiku 15: Të ardhurat e veta të bashkive me 50-100 mijë banorë




Nga analiza e të ardhurave të bashkive me popullsi ndërmjet 50-100 mijë banorë, konstatohet që mesatarisht bashkitë kanë patur një rritje të të ardhurave nga viti 2018 në vitin 2019 në rreth 2% dhe ulje të këtij raporti nga viti 2019 në vitin 2020 me rreth 24%. Ndryshe nga kategoria e bashkive me popullsi 100 – 400 mijë banorë, konstatohet që kjo kategori e bashkive kanë rritjen 8% më të vogël të të ardhurave 2019/2018 dhe po të njëjtën rënie të të ardhurave të veta në raportin 2020/2019.

Grafiku 16: Të ardhurat e veta të bashkive me 20-50 mijë banorë




Bashkite me popullsi 20-50 mijë banorë kanë patur një rritje të të ardhurave të veta me 7% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, ndërkohë që nga krahasimi i vitit 2020 me atë 2019 konstatohet një rënie mesatare e tw ardhurave të këtyre bashkive me rreth 18%. Gjithashtu, evidentohet një diferencë e madhe në treguesit e të ardhurave të Bashkisë Vorë krahasuar me grupin e bashkive me të njëjtën popullësi për shkak se aktivitetit të madh ekonomik që zhvillohet brenda juridiksionit të kësaj njësie.

Grafiku 17: Të ardhurat e veta të bashkive me më pak se 20 mijë banorë




Bashkite me më pak se 20 mijë banorë, mesatarisht në vitin 2019 kanë patur një rënie të të ardhurave me rreth 5% krahasur me vitin 2018. Kjo rënie është thelluar më tej dhe në vitin 2020, ku krahasuar me vitin 2019 është rreth 23% më pak të ardhura për këtë grupim të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 18: Të ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë




E analizuar e ndarë nga pjesa tjetër e njësive vendore, në raport me vitin 2018 Bashkia Tiranë në vitin 2019 ka pësuar një rritje të të ardhurave të veta me rreth 32%, rritje kjo e cila nuk është ruajtur në vitin 2020, i cili krahasuar me vitin 2019 ka pësuar një rënie të lehtë me rreth 4.4%.

Grafiku 19: Të ardhurat e veta të bashkive me 100-400 mijë banorë, pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe Bashkinë Tiranë




Bashkitë me popullsi nga 100 – 400 mijë banorë (pa Tiranen), pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë, kanë rritje të të ardhurave në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 vetëm 1%, ndërkohë që rënia në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është rreth 20% e këtyre të ardhurave. Gjithashtu konstatohet që bashki të tilla si Durrësi, Elbasani, Shkodër, Kamëz apo Korça kanë patur një rënie konstante të të ardhurave të veta vendore nga viti 2018 e në vazhdim deri në vitin 2020.

Grafiku 20: Të ardhurat e veta të bashkive me 50-100 mijë banorë, pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë




Bashkitë me popullsi ndërmjet 50-100 mijë banorë, të ardhura të veta pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 kanë mbledhur rreth 3 % më pak, ndërkohë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 janë siguruar nga kjo kategori e bashkive rreth 18% më pak të ardhura. Bashki të caktuara si Pogradeci, Kavaja, Kruja, Kurbin apo Vau Dejës nga viti 2018 e deri në vitin 2020 kanë pësuar gjithnjë rënie të të ardhurave të veta vendore, ndryshe nga bashkitë e tjera si Dibra, Kucova apo Divjaka që kanë siguruar më shumë të ardhura gjatë viti 2019.

Grafiku 21: Të ardhurat e veta të bashkive me 20-50 mijë banorë, pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë




Nga analiza e të ardhurave të bashkive me popullsi rreth 20-50 mijë banorë pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë, mesatarisht këto njësi në vitin 2019 krahasur me vitin 2018 kanë qëndruar në të njëjtat nivele të të ardhurave, ndërkohë që gjatë vitit 2020 këto të ardhura mesatare në raport me vitin 2019 kanë pësuar një rënie prej 14%. Në këtë grup të bashkive rënie më të madhe e kanë bashkitë Mallakastër dhe Vorë të cilat gjithashtu mbajnë dhe peshën më të madhe të të ardhurave të këtij grupi të NJVQV-ve.

Grafiku 22: Të ardhurat e veta të bashkive me 20 mijë banorë, pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë




Në grupin e bashkive nën 20 mijë banorë të cilët kanë mbledhur të ardhura pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë, gjatë viti 2019 krahasuar me vitin 2018 mesatarisht kanë patur një rënie të të ardhurave prej 7%, ndërkohë që në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ky raport ka ardhur në rënie duke kapur vlerën e rreth 21% me pak. Ndryshimin më të madh në grupin e marrë në analizë e ka bashkia Libohovë e cila ka patur një rritje të të ardhurave të veta me 188% krahasuar me vitin 2018 në vitin 2019. Në tërësi ky grup i bashkive konstatohet që kanë pësuar një rënie të të ardhurave nga viti 2018 e në vazhdim si bashkia Skrapar, Përmet, Polican, Pukë.

Grafiku 23: Të ardhurat e bashkisë Tiranë, pa përfshirë taksën e ndikimit në infrastrukturë




Grafiku 24: Të ardhurat e veta vendore sipas burimeve dhe viteve, për bashkitë me 100-400 mijë banorë (në mijë lekë)




Nga grafiku i të ardhurave të veta vendore në vite dhe sipas bashkive me popullsi ndërmjet 100-400 mijë banorë konstatohet që në vite të ardhurat nga taksat lokale kanë patur një rol të madh në financimin e këtyre bashkive. Gjithashtu viti 2019 është viti ku të ardhurat nga taksat lokale dhe taksa mbi pasurine pothuajse në të gjitha njësitë arritën vlerën më të lartë të mbledhjes.

Grafiku 25: Të ardhurat e veta vendore sipas burimeve dhe viteve, për bashkitë me 50-100 mijë banorë (në mijë lekë)




Duke marrë në analizë të ardhurat e veta të bashkive me popullsi ndërmjet 50-100 mijë banorë, evidentohet që mbizotëron burimi i taksave lokale në të gjitha njësitë e këtij grupi dhe pas tij burimi më i rëndësishëm janë të ardhurat nga taksa e pasurisë. Në këtë grupim të bashkive me një diferencë të madhe peshën më të madhe e mbajnë Bashkia Kavajë dhe Sarandë me të ardhurat nga të gjitha format e burimeve vendore.

Grafiku 26: Të ardhurat e veta vendore spas burimeve dhe viteve, për bashkitë me 20-50 mijë banorë (në mijë lekë)




Të ardhurat e veta vendore të bashkive me një popullsi ndërmjet 20-50 mijë banorë njëtrajtshmërisht ruajnë peshën që zënë në totalin e të ardhurave të këtyre bashkive në vite, përjashtim bën këtu bashkia Roskovec e cila burimin më të rëndësishëm ka taksën e pasurisë dhe bashkia Himarë tek e cila një peshë të ndjeshme e marrin taksat lokale. Gjithashtu, Bashkia Vorë si bashkia me peshën më të madhe në këtë grup të bashkive ka pësuar një rënie të ndjeshme të të ardhurave nga taksat lokale në vitin 2020.

Grafiku 27: Të ardhurat e veta vendore spas burimeve dhe viteve, për bashkitë me më pak se 20 mijë banorë (në mijë lekë)




Nga analiza e të ardhurave të veta të njësve të vetëqverisjes vendore me më pak se 20 mijë banorë, konstatohet që pjesa më e madhe e njësive nga viti 2018 e në vazhdim kanë pësuar rënie. Rënien më të madhe të të ardhurave e kanë pësuar njësi si Skrapari, Konispoli apo Libohova në të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e biznesit të vogël. Ndërkohë pothuajse në të gjitha njësitë e vetëqverisjes vendore të këtij grupi konstatohet qartë që burimi kryesor i të ardhurave mbetet taksat e veta lokale dhe taskat mbi pasurinë.

Grafiku 28: Të ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë (në mijë lekë)




Grafiku 29: Të ardhurat nga taksa e pasurisë sipas burimit dhe viteve, për bashkitë me 100-400 mijë banorë (perjashtuar Tiranën) (në mijë lekë)




Nga analiza e të ardhurave nga taksa e pasurisë për bashkitë me një popullsi ndërmjet 100-400 mijë banorë dhe përjashtuar bashkinë Tiranë evidentohet që rolin kryesor e luan taksa mbi ndërtesën, treguesi i cili në çdo vit ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë grup të të ardhurave. Një peshë të rëndësishme në të ardhurat e Bashkisë Durrës ndryshe nga bashkitë e tjera ka luajtur të ardhurat nga taksa e transaksionit të pasurive të paluajtshme.

Grafiku 30: Të ardhurat nga taksa e pasurisë sipas burimit dhe viteve, për bashkitë me 50-100 mijë banorë (në mijë lekë)



Nga analiza e të ardhurave nga taksat e pasurisë për bashkitë me popullsi nga 50-100 mijë banorë, evidentohet qartë që në varësi të resurseve natyrore dhe bashkitë sigurojnë peshë më të madhe nga forma të ndryshme të burimit. Ndryshe nga të gjitha bashkitë e tjera të këtij grupi që peshën më të madhe të të ardhurave nga taksa e pasurisë e zë taksa mbi ndërtesën, në Bashkinë Maliq dhe Divjakë peshën më të madhe e zë taksa mbi tokën bujqësore.

Grafiku 31: Të ardhurat nga taksa e pasurisë sipas burimit dhe viteve, për bashkitë me 20-50 mijë banorë (në mijë lekë)



Nga analiza e të ardhurave nga taksat e pasurisë për bashkitë me popullsi nga 20-50 mijë banorë, në shumicën e bashkive si Vorë, Roskovec, Shijak peshën më të madhe e zë taksa mbi ndërtesën. Për bashki si Rogozhinë, Ura Vajgurore apo Selenicë peshën më të madhe e zë taksa mbi tokën bujqësore. Një veçori në këtë grup të bashkive është që për bashkinë Patos burimi më i rëndësishëm i të ardhura është taksa mbi truallin.

Grafiku 32: Të ardhurat nga taksa e pasurisë sipas burimit dhe viteve, për bashkitë me më pak 20 mijë banorë (në mijë lekë)




Duke marrë në analizë të ardhurat nga taksa e pasurive për njësitë e vetëqeverisjes vendore me popullësi më pak se 20 mijë banorë, evidentohet që në shumicën e bashkive si Kolonjë, Memaliaj, Delvinë, Skrapar, Konispol peshën më të madhe e zë burimi i taksës mbi tokën bujqësore. Ndërkohë që pjesa tjetër e bashkive si bashkia Përmet, Kolonjë, Polican, Fushë Arrëz kanë si burim kryesor të taksës së pasurisë taksën mbi ndërtesën.

Grafiku 33: Të ardhurat nga taksa e pasurisë sipas burimit dhe viteve për Bashkinë Tiranë (në mijë lekë)




3. Treguesit e Shpenzimeve në Nivel Vendor


Grafiku 34: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik 2019-2020




Grafiku 35: Peshë e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike në 9M -2020/2019




Grafiku 36: Ndryshimi i totalit të shpenzimeve në 9M-2020/9M-2019 sipas NJVQV-ve




Grafiku 37: Përbërja e shpenzimeve sipas NJVQV-ve me popullsi më shumë se 100 mijë banorë




Grafiku 38: Përbërja e shpenzimeve sipas NJVQV-ve me popullsi ndërmjet 50-100 mijë banorë




Grafiku 39: Përbërja e shpenzimeve sipas NJVQV-ve me popullsi më pak se 50 mijë banorë




Grafiku 40: Përqindja e shpenzimeve sipas NJVQV-ve ndaj totalit të shpenzimeve vendore në 9M-2020




Grafiku 41: Përqindja e shpenzimeve të NJVQV-ve ndaj totalit të shpenzimeve vendore (pa Bashkinë Tiranë në 9M-2020)




Grafiku 42: Pesha e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike dhe NJVQV-ve në 9M – 2020




Grafiku 43: Përbërja e shpenzimeve sipas funksioneve të pushtetit vendor 9M-2020




Grafiku 44: Përbërja e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve dhe NJVQV-ve 9M-2020




Grafiku 45: Përbërja e shpenzimeve sipas funksioneve për NJVQV-të me popullsi më shumë se 100 mijë banorë




Grafiku 46: Përbërja e shpenzimeve sipas funksioneve për NJVQV-të me popullsi ndërmjet 50- 100 mijë banorë




Grafiku 47: Përbërja e shpenzimeve sipas funksioneve për NJVQV-të me popullsi më pak se 50 mijë banorë




Grafiku 48: Shpenzimet funksionale sipas burimit te financimit në 9M-2020



Grafiku 49: Diferenca e shpenzimeve sipas funksioneve në 9M – 2020/2019



Grafiku 50: Përbërja e shpenzimeve vendore sipas burimit në 9M-2020/2019



Grafiku 51: Përqindja e shpenzimeve sipas burimit të NJVQV-ve në 9M-2020

